



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**K.Dh.Sh.II.nr. 1691/23**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**- Departamenti i Përgjithshëm, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Faton Bajrami në çështjen përmbartimore të kreditorit Gemix SH.P.K, me NUI: 810746191, me seli në Rr. “Beteja e Koshares” p.n, në Pejë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Q.R., avokat në Skenderaj, kundër debitorit “Marigona AU” SH.P.K., me NUI: 810867335, me seli në rr. “Magjistranja Prishtinë – Gjilan”, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhomat e Shkallës së parë-Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.169/23 të datës 13.06.2023, me datë 05.03.2024, mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e debitorit “Marigona AU” SH.P.K., me seli në rr. “Magjistranja Prishtinë – Gjilan, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhomat e Shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.169/23 të datës 13.06.2023, **VËRTETOHET**.

### **A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale Dhomat e Shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.169/23 të datës 13.06.2023, ka Refuzuar në tërësi si të pa bazuar prapësimi i debitorit “Marigona AU” SH.P.K., në Prishtinë ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 208/22 i lejuar me datë 22.03.2022, nga Përmbartuesi Privat Hakif Hasi, dhe Urdhri Përmbartimor P.nr. 208/22, i lejuar me datë 22.03.2022, nga Përmbartuesi Privat Hakif Hasi, mbetet ne fuqi.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anulohet aktvendimi i Komerciale Dhomat e Shkallës së parë, KPPP.nr. 169/23 të datës 13.06.2023.

Kreditori ka ushtruar përgjigje në ankesë me të cilën ka propozuar që të refuzohet ankesa e debitorit si e pabazuar.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

- Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Gemix SH.P.K, me seli në Rr. “Beteja e Koshares” p.n, në Pejë, me dt. 22.03.2022, ka paraqitur propozim për përmbarim në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës nr. Faturës nr. 082321002-15 të datës 23.08.2021; Faturës nr. 090621013- 15 të datës 06.09.2021 dhe Faturës nr. 090821003-15 të datës 08.09.2021, duke detyruar debitorin, që në emër të përmbushjes së obligimeve nga faturat e lartcekura t’i paguajë shumën e përgjithshme prej 5,262.37 €, me kamatë ligjore prej 8 %, duke e llogaritur prej momentit kur debitori është në vonesë, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar Urdhri Përmbarimor P.nr.208/22 të datës 22.03.2022, duke theksuar se materiali i dhënë nuk ka qenë në cilësinë e duhur dhe se dëmi që i është shkaktuar nuk është kompensuar, ashtu që debitori nuk e realizon pagesën deri sa të kompensohet dëmi i shkaktuar nga ana e kreditorit të cilin e ka marr obligim. Më tutje ka shtuar se urdhri përmbarimor nuk ka bazë ligjore dhe se prapësimi i debitorit duhet të aprovohet në tërësi, të shfuqizohet urdhri përmbarimor, si dhe të obligohet kreditori t’i bart shpenzimet e procedurës. Kreditori brenda afatit ligjor përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka paraqitur përgjigje në prapësim duke i kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit, duke theksuar se secila faturë është nënshkruar nga ana e debitorit dhe nga e cila rrjedh edhe detyrimi për të paguar faturat e lartcekura. Më tutje ka shtuar se qëllimi i prapësimit është vetëm për zvarritje të procedurës dhe nuk mbështetet në shkaqet e parapara ligjore sipas nenit 71 të LPP-së. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet si i pa bazuar prapësimi i debitorit, si dhe të detyrohet debitori që të paguaj borxhin kryesor në tërësi si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarimore, përfshirë edhe shpenzimet e avokatit.

Gjykata Komerciale Dhomat e Shkallës së Parë duke vendosur lidhur me pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim: Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbarim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit

1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Po ashtu dhoma e shkallës së parë vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm – Faturën nr. 082321002-15 të datës 23.08.2021; Faturën nr. 090621013-15 të datës 06.09.2021 dhe Faturën nr. 090821003-15 të datës 08.09.2021, të cilat fatura i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, si dhe është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, të njëjtat janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt.

Tutje Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbartimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbartimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt i përmbartimit. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret këto fatura i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat janë dorëzuar në kopje të vërtetuar nga noteri, mbajnë nënshkrimin si dhe vulën e pranimit të debitorit, si dhe nuk janë kontestuar asnjëherë nga debitori.

Gjykata Komerciale – dhomat e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – dhomat e shkallës së dytë pas shikimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës si dhe ankesës se parashtruar ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejt kur e ka refuzuar prapësimin e debitorit për përmbartimit.

Andaj bazuar në të lartë cekurat, dhoma e shkallës së dytë vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të debitorit lidhur me pretendimin e tij se propozimi për përmbartim në bazë të dokumentit të besueshëm nuk e përmban origjinalin apo kopjen e vërtetuar të dokumentit të besueshëm kundër urdhrin përmbartimor P.nr. 208/22, i datës 22.03.2022, për shkak se e njëjta nuk është pranuar dhe nënshkruar dhe nuk përmban vulë të debitorit, e cila dëshmon se personi kompetent e ka pranuar një faturë të tillë. Po ashtu debitori thekson se për të qen dokument i

besueshme për përmbardim duhet ti përmbaj te gjitha elementet e kërkua në përputhje me nenin 29 dhe 37 te LPP-se.

Ndërsa dhoma e shkallës së dytë e vlerëson përgjigjen në ankesë të kreditori duke theksuar se fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri është pranuar nga ana e debitorit dhe i njëjti nuk ka paraqitur kundërshtime ndaj tyre. Ka shtuar se pretendimi i debitorit nuk qëndron se faturat nuk i plotësojnë kushtet për përmbardim ngase faturat nuk janë pranuar apo nënshkruar dhe nuk përmban vulën e debitorit e cila dëshmon se personi kompetent e ka pranuar një fature te tillë. Theksoj se debitorit nuk ka bashkangjitur asnjë provë të vetme për ti mbështetur pretendimet e tij ankimore. Për këto arsye, gjykatës i ka propozojmë që ta refuzoj prapësimin e debitorit si të pabazuar, ndërsa urdhri përmbardimor të mbetet në fuqi.

Gjykata e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës e dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë i bazuar. Më te drejt gjykata e shkalles se parë ka vlerësuar se debitorit në rastin konkret nuk ka ofruar prova juridikisht te vlefshme ne mbështetje te pretendimeve të tij.

Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e debitorit e pathemeltë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 te Ligjit nr. 08/L-015 të LPP-së.

## **GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

**Dhoma e shkallës së dytë**

**K.Dh.Sh.II.nr.1691/23 me datë 05.03.2024**

**Gjyqtari,  
Faton Bajrami**